

Përkthimi i dokumenteve

Përshkrimi

Përkthimi i dokumenteve dhe akteve të tjera zyrtare nga gjuha shqipe në gjuhën e vendit pritës, ose në një gjuhë tjetër dhe nga gjuha e vendit pritës ose nga një gjuhë tjetër në gjuhën shqipe

Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Dokument identifikimi si pasaportë ose kartë identiteti biometrike;
- 2) Dokumenti origjinal, lëshuar në përputhje me legjislacionin përkatës;
- 3) Mandat-pagesë për arkëtimin me transferim bankar të tarifës së shërbimit;

Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja dorazi ose me postë e dokumentit për t'u përkthyer;
- 2) Konsulli merr dokumentin e verifikon atë për rregullsi dhe bën përkthimin e tij
- 3) Kopja e dokumentit të përkthyer pasi i është vendosur pulla taksë mbahet në arkivin e ambasadës apo konsullatës;

Tarifa e shërbimit dhe afati

10 euro faqja ose shuma ekuivalente në monedhën vendase.

Në momentin e paraqitjes, ose 3 – 5 ditë pune deri në kthimin me postë;

Zyra

Të gjithë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

Shënime

Përkthimet e dokumenteve nga punonjësi konsullor janë të barasvlershme me ato të një përkthyesi të regjistruar tek një noter në Republikën e Shqipërisë dhe për pasojë nuk kanë nevojë të noterizohen.

Pranë postit konsullor mbahet një listë e përditësuar e përkthyesve të njohur për t'ua rekomanduar personave të interesuar për përkthime të ndryshme.